REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE

DHOMA E AVOKATISË
E SHQIPËRISË
CHAMBER OF ADVOCACY OF ALBANIA

Nr.235 Prot., datë 19.02.2024

Nr.115 Prot., datë 19.02.2024

MARRËVESHJE KUADËR

PËR BASHKËPUNIM INSTITUCIONAL

MBI ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE SHKENCORE TË PËRBASHKËTA

Ndërmjet

GJYKATËS KUSHTETEUSE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Dhe

DHOMËS SË AVOKATISË SË SHQIPËRISË

Duke mbajtur parasysh interesin e përbashkët të institucioneve në zhvillimin e mendimit juridik, të doktrinës dhe të botimeve shkencore, me qëllim promovimin e kërkimit shkencor dhe rritjen e kapaciteteve të praktikantëve të ligjit, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë (Palët), marrin përsipër të realizojnë aktivitete shkencore të përbashkëta periodike.

Në përputhje me qëllimin e Marrëveshjes, Palët bien dakord të bashkëpunojnë duke përcaktuar se:

Neni 1
Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qellim bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor dhe rritjen e kapaciteteve të praktikantëve të ligjit, pa cenuar pavarësinë dhe paanshmërinë e secilës Palë në ushtrimin e funksionit të tyre.

Neni 2
Objekti

Palët, brenda fushëveprimit të detyrave dhe funksioneve të tyre përkatëse të caktuara me ligj, bashkëpunojnë për identifikimin dhe zhvillimin e tematikave të nevojshme për tu trajtuar në Konferenca Shkencore, Trajnime, Seminare, Tryeza Pune të përbashkëta, në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut dhe të drejtat e lidhura me to.

Neni 3
Aktivitetet dhe Burimet

Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta, do të vendoset në bashkëpunim midis dy institucioneve, sipas tematikave për të cilat lind nevoja.
Ato do të koordinohen nga Titullarët e institucioneve duke vënë në dispozicion burimet njerëzore dhe instrumentet për t'u përdorur nga vetë palët.

Neni 4
Publikimi

Punimet shkencore që të hartohen në Kuadër të Aktiviteteve të Përbashkëta do të botohen në gjuhën shqipe dhe angleze, ose në një nga pesë gjuhët zyrtare të BE-se dhe do te publikohen nga secila palë në platformat e tyre të komunikimit. Këto punime do të botohen dhe në Revistën Shkencore Avokatia, në përputhje me nenin 5 të kësaj marrëveshje.

Neni 5
Pronësia intelektuale

Palët marrin përsipër të zbatojnë kuadrin ligjor vendas mbi pronësinë intelektuale.
Rezultatet dhe projektet e zhvilluara së bashku janë në pronësi të përbashkët të palëve të interesuara.

Çdo e drejtë e pronësisë intelektuale mbahet tek secili institucion dhe mund të përdoret nga Palët e tjera për aktivitetet e përmendura në këtë Marrëveshje vetëm me pëlqimin e shprehur të Palës që e ka prodhuar.

Neni 6
Publiciteti i Marrëveshjes

Palët bien dakord mbi rëndësinë e publicitetit të duhur për përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje dhe për aktivitetet e lidhura me të.
Për këtë qëllim, Palët marrin përsipër ta shpërndajnë atë përmes një njoftimi të përbashkët për shtyp dhe, në përgjithësi, nëpërmjet një veprimtarie të përbashkët komunikimi.

Neni 7
Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga titullarët e dy institucioneve dhe mbetet në fuqi për një periudhë pesë vjeçare.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Holta Zacaj LL.M

Kryetari i Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë

Prof. Dr. Maksim Haxhia